



# Kolegji AAB

Rr. "Elez Berisha", nr. 56, Zona Industriale  
Prishtinë-Fushë Kosovë, 10000 Prishtinë,  
Republika e Kosovës,  
Tel: +383 38 600 005; +383 45 284 797  
Mail: [info@aab-edu.net](mailto:info@aab-edu.net);  
[www.aab-edu.net](http://www.aab-edu.net)

Ref. nr. 279/2023 Prishtinë, 10/05/2023



Në bazë të nenit 27 të Statutit të Kolegjit AAB dhe pas konsultimit me Kolegjumin e Dekanëve, Rektori me datën 10/05/2023 merr këtë:

## V E N D I M

Për përkufizimin dhe përcaktimin e kritereve kundër plagjiaturës

### I. Përkufizimi i plagjiaturës:

- Plagjiatura, në përputhje me standarde ndërkombëtare, definohet si praktika e marrjes së punës dhe / ose ideve të dikujt tjetër duke pretenduar se janë origjinale.
- Në përputhje me definicionin e përgjithshëm, plagjiatura përkufizohet më tutje si në vijim:
  - Marrja fjalë-për-fjalë të tekstit apo fjalive nga një burim pa e cituar atë burim;
  - Ndryshimi i fjalëve dhe frazave kyçe, por duke ruajtur përbajtjen thelbësore të burimit;
  - Parafrazim nga burime të shumta dhe të kombinuar për t'u përshtatur së bashku;
  - Huazimi bujar nga vepra e mëparshme e shkrimtarit pa citim;
  - Kombinimi i burimeve të cituara me pasazhe të kopjuara pa citim;
  - Përfshirja e citimeve të burimeve joekzistente ose informacione të pasakta në lidhje me përbajtjen e burimeve;
  - Përfshirja e citimeve të duhura në burime, por punimi kopjon përbajtjen e punës origjinale;

### II. Mekanizmat kundër plagjiaturës:

- Mekanizmat kundër plagjiaturës kanë të bëjnë me rritjen e ndërgjegjësimit dhe parandalimin.
- Në nivelin e ndërgjegjësimit, studentët dhe stafi akademik, pajisen me paketa informuese të cilat përshkruajnë parimet e integritetit dhe sjelljes akademike, dhe të cilat janë specifike dhe të përshtatura për secilin akter veç e veç.
- Në nivelin e parandalimit, varësisht nga lloji i punimeve dhe/apo vlerësimeve, përdoren procedura dhe softuerë kundër plagjiaturës.
  - Procedurat përfshijnë komunikimin e obliguar dhe minimal në mes të studentit dhe stafit akademik për detyrën dhe/apo punimin e studentit,

dhënen e informatave kthyese për punimet dhe/apo vlerësimet e studentit, nënshkrimin e deklaratës nën betim se punimi i studentit është origjinal, etj.

3.2. Softuerët kundër plagjiaturës përdoren nga stafi akademik për detyra, ese dhe tekste të tjera të shkruara përgjatë lëndëve të ofruara.

4. Në nivelin e disertacionit bachelor dhe master, përpos elementeve të përmendura në nën paragafin 3.1 të këtij neni, softueri kundër plagjiaturës përdoret detyrimisht me dorëzimin e disertacionit.

5. Për të kaluar tema e diplomës tek komisioni vlerësues, mentorët obligohen të dorëzojnë një raport kundër plagjiaturës që detajon nivelin e plagjiaturës së kryer në tezë.

6. Niveli i pranueshëm i plagjiaturës është rezultati prej 20%, që përputhet me frazat e cituara në gjithë temën.

7. Nëse zbulohet më shumë se 20% plagjiaturë, tema e diplomës nuk mund të dorëzohet për shqyrtim te komisioni vlerësues. Në vend të kësaj, studentit i kërkohet të rishikojë dhe rishkruajë pjesë të disertacionit.

### **III. Zbatimi**

1. Ky vendim fillon së aplikuari nga momenti i nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, kujdesen të gjitha trupat akademike dhe Komisioni i Etikës.



Prishtinë, 2023